



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 07/L - 035**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË KREDISË PËR  
LIKUIDITET TË URGJENCËS SË INFRASTRUKTURËS VITALE,  
NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BANKËS EVROPIANE  
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË KREDISË PËR  
LIKUIDITET TË URGJENCËS SË INFRASTRUKTURËS VITALE,  
NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BANKËS EVROPIANE  
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim që të ratifikojë Marrëveshjen e Kredisë për Likuiditet të Urgjencës së Infrastrukturës Vitale, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, e nënshkruar me 17 gusht 2020.

**Neni 2**  
**Ratifikimi i Marrëveshjes**

Nëpërmjet këtij ligji ratifikohet Marrëveshja e Kredisë për Likuiditet të Urgjencës së Infrastrukturës Vitale, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, e nënshkruar me 17 gusht 2020.

**Neni 3**  
**Dokumentet e bashkëngjitura**

Në shtojcën e këtij ligji është bashkëngjitur Marrëveshja e Kredisë për Likuiditet të Urgjencës së Infrastrukturës Vitale, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

**Neni 4**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 07/L-035**  
**28 dhjetor 2020**

**Arbërie NAGAVCI**  
**Nënkryetare e Kuvendit**